



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11 dhe 17 shkronja k, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, neneve, 14 dhe 19 shkronja k të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-1/298-10 dhe nenit 1 pika 3 të Rregullores për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr.1/172-400 të datës 27 shtator 2012, në kërkesë të Qendrës së Rehabilitimit Bazuar në Bashkësi "Handikos" në Podujevë nr.06-500/04-0005056/18 të datës 22.01.2018, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 28 shkurt 2018, mori,

VENDIM PËR MBËSHTETJE FINANCIARE QENDRËN E REHABILITIMIT BAZUAR NË BASHKËSI "HANDIKOS" – PODUJEVË

Neni 1

Qendra e Rehabilitimit Bazuar në Bashkësi - QRBB "Handikos" në Podujevë, për zhvillimin e aktiviteteve programore dhe mbulimin e shpenzimeve operative të veprimtarisë, sipas objektivave strategjike për vitin 2018, mbështetet me mjete financiare në shumë të gjithmbarshme prej 14,556.00 €.

Neni 2

Mjetet financiare sipas nenit 1 të këtij Vendimi, janë të planifikuara në buxhetin e Komunës për vitin 2018 në kategorinë subvencione dhe transfere, kodi buxhetor 75521, n'kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Shuma e mjeteve e përcaktuar në nenin 1 të këtij Vendimi, bartet në llogarinë bankare QRBB "Handikos" në Podujevë, në këste proporcionale mujore.

Neni 3

Zbatimin e Vendimit e bëjnë Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 8.11 të Rregullores (QRK) nr.01/2016 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave.

Nr.01-400/03-0014937/18
Podujevë,
28 shkurt 2018

